



Impiant elektrik Smart with Netatmo

Udhëzuesi për instaluesin

bticino



Impiant elektrik Smart with Netatmo

Udhëzuesi për instaluesin

Përmbajta

Karakteristikat e përgjithshme	4
Instalo Impiantin elektrik Smart with Netatmo	6
Lidh pajisjet me fije	10
Shto një pajisje me fije	15
Shto një komando skenarë wireless	17
Lidh komandon drita/grila wireless me një ose më shumë pajisje me fije modulare	20
Shkëput një komando wireless nga pajisjet me fije	25
Rivendos parametrat e fabrikës	26
Përdor App	27

Karakteristikat e përgjithshme

Gateway të lejon të krijosh impiantin tënd elektrik Smart duke e lidhur me të gjitha pajisjet me fije dhe wireless.

Ju jepet në dispozicion komando skenari Hyr/Dil wireless Master e nevojshme për procedurën e lidhjes me të gjitha pajisjet dhe për aktivizimin e skenarëve të tua "hyr në shtëpi" dhe "dil nga shtëpia".

Falë lidhjes Wi-Fi (vetëm 2,4GHz), Gateway lidhet me routerin e shtëpisë tënde për të lejuar kontrollin lokal ose në distancë të dritave, prizave të komanduara dhe grilave me anë të smartphone-ve (App "Home + Control") ose komandove zanore (duke përdorur një asistent zanor). Për të përmirësuar marrjen e sinjalit këshillohet instalimi i Gateway afër router-it.

Konsiderata të përgjithshme për pajisjet dhe funksionet e ilustruara në këtë udhëzues:

- për paraqitjen grafike të pajisjeve është përdorur si shembull, seria Living Now with Netatmo;
- unksionet e përshkruara janë të vlefshme për të gjitha seritë civile with Netatmo. Është e mundur të shtohen funksione të tjera (psh. përdorim i ngrohjes), duke përdorur pajisje të tjera në ofertë with Netatmo (psh. Smarther with Netatmo);
- produktet dhe funksionet e ilustruara mund të mos jenë të disponueshme për të gjitha tregjet. Verifiko me furnizuesin tënd dhe instaluesin e besuar disponueshmërinë e tyre.


Pajisje me fije

Gateway					
	Gateway modular	Gateway + prizë lloji F	Gateway + prizë lloji E		
Prizë					
	Modul me fije për prizë modulare	Prizë e lidhur lloji F	Prizë e lidhur lloji E	Prizë e lidhur lloji F Plug&play	Prizë e lidhur lloji E Plug&play
Dritat					
	Devijues me fije	Rregullator/Çelës elektrik me fije	Rregullator/Çelës elektrik me fije modular	Rele dritash me fije	
Grila					
	Komando për grila me fije	Komando për grila me fije 2 modular		Aktuator me fije për grila	

Impiant elektrik Smart with Netatmo

Udhëzuesi për instaluesin

Komando wireless




Komando për drita wireless brenda muri


Komando për grila wireless brenda muri

Komando për skenarë wireless brenda muri


Komando për skenarë wireless Natë/Ditë brenda muri




Komando për drita wireless sipërfaqësore



Komando dyshe dritash wireless sipërfaqësore




Komando 4 skenarë wireless sipërfaqësore




Komando skenarë Hyr/Dil wireless sipërfaqësore




(*) Modul wireless për çelësin elektrik mekanik



Komando për grila wireless sipërfaqësore



Sensor lëvizjesh wireless





Komando skenarë Natë&Ditë wireless sipërfaqësore

(*) **Shënim:** modul wireless për çelësin mekanik mund të përdoret për të komanduar një dritë nga disa pozicione. Veçse nuk është e mundur të komandohen disa drita me një modul të vetëm wireless për çelësin mekanik.

Instalo Impiantin elektrik Smart with Netatmo




1. Hiq tensionin nga sahati shpërndarës i përgjithshëm.



- Verifiko heqjen e tensionit nga impianti.
Tani mund të lidhësh të gjitha pajisjet e impiantit tënd si tek skemat e mëposhtme.


Implant elektrik Smart with Netatmo

Udhëzuesi për instaluesin





2. Riaktivizo lidhjen elektrike duke përdorur kutinë elektrike të përgjithshme.




Verifiko që dritat LED të të gjitha pajisjeve të fiksohen të kuqe (përveç atyre wireless që janë në gjendje të fikur).

Impiant elektrik Smart with Netatmo

Udhëzuesi për instaluesin

Pasi të instaloni impiantin elektrik smart, pa kryer veprime të tjera, mund të komandosh lokalisht dritat dhe grilat.




Shëno: prizat e lidhura do të jenë në gjendjen elektrike të default.

Tani mund të lidhësh të gjitha pajisjet për të shfrytëzuar funksionet e lidhura me impiantin tënd.

Lidh pajisjet me fije


Kryeje procedurën e lidhjes si ilustruar më poshtë, brenda 15 minutash pasi ke ndezur impiantin. Në të kundërtën, përsërit veprimin nga fillimi.



1. Hiq tensionin nga sahati shpërndarës i përgjithshëm.
2. Prit 1 minutë.




3. Riaktivizo lidhjen elektrike duke vepruar tek sahati shpërndarës elektrik.
4. Prit 1 minutë për të ndezur në mënyrë korrekte impiantin.




Impiant elektrik Smart with Netatmo

Udhëzuesi për instaluesin




Komando skenarë Hyr/Dil wireless master

5. Hiq shiritin mbrojtës nga Komando skenarë Hyr&Dil wireless Master që gjendet në Gateway modular.




6. Shtyp për pak kohë njërin nga dy butonat e komandos, LED-i ndriçon i gjelbër, lëre dhe prit që të kalojë në gjendje të fikur.
* Nëse procedura nuk shkon mirë, hiq dhe vendos përsëri baterinë, më pas përsërit veprimin.

Kujdes: mos shtyp butonat e komandove wireless nëse cover-at nuk janë montuar.




Drita LED e Gateway, nga ngjyra e kuqe kalon në gjendje të fikur.



Komando skenarë Hyr/Dil wireless master

7. Kryej lidhjen:

shtyp dhe mbaje të shtypur në të njëjtën kohë të dy butonat e komandas, LED-i i gjelbër ndizet, LED-i fiket.




Verifiko që dritat LED të të gjitha pajisjeve të kalojnë fiks të gjelbëra (përveç atyre wireless që janë në gjendje të fikur).

Shëno: në rastin e prizave plug&play, ky operacion nuk është automatik, por është e nevojshme të mbahet shtypur butoni ON/OFF deri sa led-i të fillojë të ndriçojë i gjelbër.

Shëno: Ndryshimi i të gjithëve led -evenga e kuaja në gjelbër mund të bëhet deri në 15 minuta. Pas kësaj kohe, procedura do të mbyllet automatikisht.

Impiant elektrik Smart with Netatmo


Udhëzuesi për instaluesin



Komando skenarë Hyr/Dil wireless master

8. Përfundo lidhjen:

shtyp për pak e njëkohësisht dy butonat e komandos, LED-i ndriçon njëherë i gjelbër, prit që të kalojë në gjendje të fikur.




Verifiko që dritat LED të të gjitha pajisjeve të kalojnë menjëherë në gjendje të fikur, tani pajisjet me fije janë lidhur midis tyre.

Shënim: nëse në ndonjë pajisje mbetet ledi i kuq, ndërpre tensionin e të gjithë impiantit, prit të paktën një minutë, sill korrentin, prit një minutë dhe nis përsëri nga pika 1.

Pasi ke lidhur Komandon e skenarëve Hyr&Dil wireless master, mund të aktivizosh skenarët Hyr Dil nga kjo Komando.

Shëno: instalo dhe lidh impiantin App Home + Control për të shfrytëzuar plotësisht funksionet e sistemit.




Butoni i sipërm kryen skenarin **HYR**


☐ Grilat LART

⚡ Asnjë efekt tek prizat

📍 Asnjë efekt tek dritat dhe releja



Shëno: prit disa minuta pasi të kesh përfunduar lidhjen para se të aktivizoh skenarët.




Butoni i poshtëm kryen skenarin **DIL**

📍 Drita dhe rele OFF,

☐ Grilat POSHTË

⚡ Asnjë efekt tek prizat



Gjithashtu mund të shtosh komando të tjera për skenarë wireless (shiko paragrafin Shtu një komando skenarë wireless).

Shëno: Komando skenarë Natë&Ditë wireless është parapërgatitur për të komanduar skenarët Natë dhe Ditë. Mund të përcaktosh më vonë veprimet që do të kryejnë këta skenarë App **Home + Control**.


Shto një pajisje me fije

Në këtë procedurë, pajisja me fije është si shembull; për listën e plotë të pajisjeve me fije të përdorueshme shih paragrafin "Karakteristikat e përgjithshme".

Në rastin kur është aktivizuar App Home + Control, ndiq udhëzimet nga menuja "Shto një produkt në këtë shtëpi" nga App, përndryshe:




1. Hiq tensionin nga sahati shpërndarës i përgjithshëm.



2. Instalo pajisjen e re me fije.



3. Riaktivizo korrentin duke vepruar në sahatin shpërndarës dhe prit 1 minutë për ndezjen normale të impiantit.



Verifiko që dritat LED të të gjitha pajisjeve të jenë në gjendje të fikur përveç pajisjes që duhet të shtoni e cila duhet të jetë me ngjyrë të kuqe fikse.


4. Kryej lidhjen e pajisjes së re si treguar në paragrafin "Lidh pajisjet me fije" (pika 1).

Shëno: kjo procedurë, nëse kryhet nga App, do të sugjerojë saktësisht të njëjtën radhë veprimesh këtu të përshkruar.

Shto një komando skenarë wireless

Në këtë procedurë, komandoja skenarë Ditë/Natë është si shembull; për listën e plotë të pajisjeve wireless të përdorueshme shih paragrafin "Karakteristikat e përgjithshme".


Në rastin kur është aktivizuar App Home + Control, ndiq udhëzimet nga menuja "Shto një produkt në këtë shtëpi" nga App, përndryshe:




Komando skenarë Hyr/Dil wireless master

1. Kryej lidhjen:

shtyp dhe mbajti të shtypur njëkohësisht dy butonat e komandos master, LED-i ndizet i gjelbër, lëshoje prit që të kalojë në gjendje të fikur.




Verifiko që dritat LED të të gjitha pajisjeve të ndryshojnë në të gjelbër fiks (përveç atyre wireless që janë në gjendje të fikur).



Komando skenarë Hyr&Dil wireless

2. Hiq mbulesën nga Komando skenarë që duhet shtuar.



Kujdes: Mos shtyp butonat e komandove wireless nëse cover-at nuk janë montuar.

3. Shtyp për pak kohë njërin nga dy butonat e komandos, LED-i ndriçon i gjelbër, lëre dhe prit që të kalojë në gjendje të fikut.


* Nëse procedura nuk shkon mirë, hiq dhe vendos përsëri baterinë, më pas përsërit veprimin.

4. **Përfundo lidhjen:**

shtyp për pak e njëkohësisht dy butonat e komandos master, LED-i ndriçon njëherë i gjelbër, prit deri sa të kalojë në gjendje të fikut.

Impiant elektrik Smart with Netatmo

Udhëzuesi për instaluesin




Verifiko që dritat LED të të gjitha pajisjeve të kalojnë menjëherë në gjendje të fikur, tani komandoja është lidhur me impiantin smart dhe mund të komandosh skenarët Hyr Dil dhe/ose Ditë Natë. Gjithashtu mund të shtosh Komando dritash dhe grilash wireless si në procedurën e sipërme.

Lidh komandon drita/grila wireless me një ose më shumë pajisje me fije modulare

Në këtë procedurë, komandoja e dritave është si shembull; për listën e plotë të komandave drita/grila shih paragrafin "Karakteristikat e përgjithshme".


Në rastin kur është aktivizuar App Home + Control, ndiq udhëzimet nga menuja "Shto një produkt në këtë shtëpi" nga App, përndryshe:



Komando skenarë Hyr/Dil wireless master

1. Kryej lidhjen:


shtyp dhe mbajti të shtypur njëkohësisht dy butonat e komandos master, LED-i ndizet i gjelbër, lëshoje prit që të kalojë në gjendje të fikur.



Verifiko që dritat LED të të gjitha pajisjeve të ndryshojnë në të gjelbër fiks (përveç atyre wireless që janë në gjendje të fikur).

Impiant elektrik Smart with Netatmo


Udhëzuesi për instaluesin



**Komando dritash wireless
ose
Komando për grila wireless**

2. Hiq shiritin mbrojtës nga komandoja e re.


Kujdes: mos shtyp butonat e komandove wireless nëse cover-at nuk janë montuar.




3. Shtyp për pak njërin nga dy butonat e komandas, LED-i fillon të ndriçojë i gjelbër, prit që të kalojë në gjendje të fikur.

* Nëse procedura nuk shkon mirë, hiq dhe vendos përsëri baterinë, më pas përsërit veprimin.


Tani komandoja është lidhur me impiantin elektrik smart.



4. Shtyp dhe mbaje të shtypur njërin nga dy butonat e komandos wireless që dëshiron të lidhësh, **trokit lehtë tri herë (në mënyrë delikate dhe me shpejtësi)** me komandon mbi pajisjen me fije që dëshiron të lidhësh.



Komando dritash wireless
ose
Komando për grila wireless



Pajisje me fije


Dritat LED ndriçojnë tri herë blu, lëshojë presionin nga komandoja wireless.

Drita LED e komandos kalon nga ndriçimi blu në gjendje të fikur, më pas aktivizohet për një sekondë blu e fiket përsëri, LED-i i pajisjes me fije kalon nga ndriçimi blu në të gjelbër, më pas ndizet blu përsëri për një sekondë dhe kthehet përsëri i gjelbër.

Në rastin kur pajisja me fije për t'u lidhur është thjesht një, kalo tek numri 6 për të përfunduar lidhjen, përndryshe vazhdo si është ilustruar në pikën 5.


Pajisjet me fije për t'u lidhur me komandot, mund të jenë të llojit të ndryshëm, gjithmonë duke respektuar përputhshmërinë me funksionin drita ose grila.

Në këtë shembull, pajisja e parë është një devijues me fije, e dyta një modul për prizë me fije.



5. Shtyp dhe mbaje të shtypur njërin nga dy butonat e komandos wireless që dëshiron të lidhësh, **trokit lehtë tri herë (në mënyrë delikate dhe me shpejtësi)** me komandon mbi pajisjen me fije që dëshiron të lidhësh.

***Shëno:** prizat e lidhura mund të lidhen me një komando wireless drita. Këto prizat nuk aktivizohen fillimisht nga komandot skenarë wireless që komandojnë drita, por mund të përcaktosh ose ndryshosh veprimet që ekzekutojnë katër skenarët me App Home + Control, dhe vendosi.




*Komando dritash wireless
ose
Komando për grila wireless*

Pajisje me fije

Dritat LED ndriçojnë tri herë blu, lëshojë presionin nga komandoja wireless.


Drita LED e komandos kalon nga ndriçimi blu në gjendje të fikur, më pas aktivizohet për një sekondë blu e fiket përsëri, LED-i i pajisjes me fije kalon nga ndriçimi blu në të gjelbër, më pas ndizet blu përsëri për një sekondë dhe kthehet përsëri i gjelbër.



Komando skenarë Hyr/Dil wireless master

6. Përfundo lidhjen:


Shtyp për pak e njëkohësisht dy butonat e komandos master, LED-i ndriçon njëherë i gjelbër, prit deri sa të kalojë në gjendje të fikur.



Verifiko që dritat LED të të gjitha pajisjeve të kalojnë menjëherë në gjendje të fikur, tani lidhja është kryer saktë.
Përsërit procedurën e ilustruar për çdo pikë komandoje wireless nga e cila synon të komandosh pajisjet me fije.

Shkëput një komando wireless nga pajisjet me fije

Shëno: komandoja wireless objekt i procedurës, është si shembull; për listën e plotë të komandave wireless shih paragrafin "Karakteristikat e përgjithshme".



*Komando dritash wireless
ose
Komando për grila wireless*


1. Shtyp njëkohësisht dy butonat e komandos që do të shkëputësh deri sa të ndizet LED-i portokalli.
Hiqe gishtin për sa kohë LED-i është portokalli.
2. Shtyp për pak e njëkohësisht dy butonat e komandos, LED-i ndriçon njëherë i gjelbër, më pas kalon në gjendje blu e më pas fiket.

Rivendos parametrat e fabrikës

Kujdes: kjo procedurë shkëput komplet pajisjen nga pajisja e impiantit elektrik smart.


Kujdes: mos kryej asnjëherë reset-in e Komandos skenarë Hyr&Dil wireless master; nëse gabimisht kryhet reset-i, fillo lidhjen me rrjetin zigbee duke shtypur për pak kohë pulsantin reset në gateway, më pas shtyp pak një buton të Komandos skenarë Hyr&Dil wireless master dhe prit lidhjen (led-i i komandos ndriçon i gjelbër disa herë e më pas fiket).

Procedura për komando wireless:



1. Shtyp dhe mbaje shtypur butonin reset* erisa LED-i të bëhet i kuq. Në këtë pikë lëshojeni butonin. LED-i do të ndriçojë ngjyrë të gjelbër, më pas do të ndriçojë ngjyrë të kuqe dhe më pas do të fiket.
***Shënime:** Për disa seri estetike, është e nevojshme të hiqen cover dhe pllaka për të përdorur butonin reset.

Procedura për pajisje me fije:



2. Shtyp dhe mbaje shtypur butonin reset* derisa LED-i të bëhet i kuq. Në këtë pikë lëshojeni butonin. Rivendosja është kryer me sukses.

***Shënime:** Për disa seri estetike, është e nevojshme të hiqen cover dhe pllaka për të përdorur butonin reset.

Kujdes: shtypja e shkurtër pa dashje e butonit reset, fillon lidhjen (LED të gjelbër ndezur). Shtyp për pak kohë dhe njëkohësisht të dy butonat e Komandos skenarë Hyr&Dil wireless master për ta përfunduar.

Përdor App

Kur të kryhet lidhja e të gjitha pajisjeve me fije me gateway dhe komandove wireless të dëshiruara të lidhura me pajisje me fije menjëherë do të jetë e mundur:

- aktivizo skenarin "HYR" të gjitha grilat ngrihen lart
- aktivizo skenarin "DIL" të gjitha dritat fiken dhe të gjitha grilat ulen poshtë.
- komando dritat, prizat dhe grilat nga komandot përkatëse wireless

Shkarko App-in "**Home + Control**" dhe konfiguroje për të përdorur të gjitha funksionet e impiantit elektrik Smart:

- personalizimi i skenarëve
- kontroll në distancë me Smartphone
- kontroll zanor duke përdorur asistentin tënd zanor të preferuar
- marrje njoftimesh në rast mbingarkese ose anomali të impiantit
- verifikim i konsumimit elektrik

për informacione të mëtejshme referojuni faqes internet
www.homesystems-legrandgroup.com



Për të shkarkuar App-in **Home + Control**



